



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Nënshkruar më 04.03.2023, në mes:

Universitetit "Haxhi Zeka" (në tekstin e mëtejshëm UHZ), të cilën e përfaqëson Prof. dr. Armand Krasniqi - rektor dhe

"Devolli Corporation" (në tekstin e mëtejshëm DCo), të cilën e përfaqëson z. Barlet Imami

Terminologjia e përdorur në kuadër të kësaj marrëveshje:

- 1) **Universiteti "Haxhi Zeka"** përfshin të gjitha njësitet akademike (Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe Mjedisit, Fakulteti i Agrobiznesit, Fakulteti Juridik dhe Fakulteti i Arteve) dhe njësitet organizative (Biblioteka, Qendra për karrierë, Qendra për Ekselencë, Instituti për Shkencë dhe Arte, Qendra për Përkrahje të Bizneseve;
- 2) **Devolli Corporation** përfshin të gjitha njësitet dhe shoqëritë tregtare të cilat në kuptimin ekonomik konsiderohen kompani bija të korporatës;
- 3) **Kompania mëmë** nënkupton shoqërinë tregtare "Devolli Corporation";
- 4) **Njësitet bija** nënkupton shoqëritë tregtare të cilat juridikisht janë të pavarura por të cilat në planin ekonomik janë në pronësi të "Devolli Corporation";
- 5) **Bona fide (mirëbesim)**-parim fundamental në të drejtën private, sipas të cilit parim palët duhet të veprojnë në një marrëdhënie juridike me mirëbesim dhe duke mos i bërë keq palës kontraktuese. Ky parim është mishëruar në nenin 4 të LMD.

Pika 1

Synimi i marrëveshjes

- 1.1. Synimi i kësaj marrëveshje ekskluzivisht është i fokusuar në fushën e zhvillimit të një bashkëpunimi mbi parimet "**bona fide**" midis UHZ dhe DCo për t'i dhënë njëra tjetrës ekspertizën, përvojën dhe ndihmën, secila nga fusha e veprimtarisë së vet deri në masën sa është e lejuar dhe e zbatueshme për politikën e secilës palë në këtë marrëveshje.
- 1.2. Qëllimet kryesore të kësaj marrëveshje bazohen në krijimin e mundësive për zhvillimin e përbashkët të:
 - a) programeve të studimit me fokus tregun dhe ekonominë dinamike ndaj të cilave janë të orientuara palët;
 - b) krijimit të kushteve për realizimin e punëve praktike të studentëve, studiuesve dhe profesorëve të UHZ në mjediset e DCo –së;
 - c) krijimit dhe të realizimit të projekteve të përbashkëta me interes të përbashkët në mes të Universitetit Haxhi Zeka dhe Kompanisë Devolli;



- d) programeve të përbashkëta për krijimin e forumeve për zhvillim ekonomik, lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar; dhe
- e) aktiviteteve tjera që janë në frymën e kësaj marrëveshjeje.

Pika 2

Zhvillimi i programeve të studimit

- 2.1. UHZ do të hartojë programe të studimit të personalizuar për nevojat e kompanisë Devolli, duke siguruar që këto programe të jenë në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të cilat do të kontribuojnë në rritjen e aftësive, njohurive dhe punësimit të studentëve në këtë korporatë çdo herë në bazë të nevojave që ka ajo.
- 2.2. DCo do të mundësojë trajnimin praktik për studentët, studiuesit dhe profesorët e UHZ, duke ofruar mundësi praktike nëpër njësi bija dhe kapacitete të tyre industriale, shërbyese dhe tregtare.

Pika 3

Puna praktike dhe sezonale

- 3.1. DCo do të angazhojë studentët e UHZ në punë praktike sezonale dhe ato të ndërmarrësisë, duke u mundësuar studentëve përvojë të vlefshme të punës dhe trajnimit;
- 3.2. Studentët e UHZ do të marrin pjesë në programet e punës praktike dhe të trajnimeve që ofrohen nga DCo, nëpërmjet të cilave do të zhvillojnë njohuri dhe aftësi praktike, duke i përgatitur për karrierën e tyre të ardhshme.

Pika 4

Puna e studentëve të angazhuar sipas nevojave të DCo

- 4.1. DCo do të ofrojë mundësi pune dhe angazhimi në të gjitha fushat e korporatës për studentët e UHZ, sipas nevojave të biznesit të DCo.
- 4.2. Studentët e UHZ do të kenë mundësi të angazhohen në punë të përhershme në DCo, nëse ata demonstrojnë njohuri dhe aftësi të mjaftueshme për të punuar në pozitat relevante të korporatës ose të njësive bija.



Pika 5

Krijimi dhe realizimi i projekte inovative, shkencore, zhvillimore dhe hulumtuese

- 5.1. UHZ dhe DCo do të bashkëpunojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për hulumtim shkencor – teknologjik.
- 5.2. UHZ do të ofrojë ekspertizën e tij në disiplina të ndryshme, në kuadër të projekteve të përbashkëta.
- 5.3. DCo, sipas interesit të vet dhe sipas mundësive, mund të ofrojë burime financiare, teknologjike dhe njerëzore për të ndihmuar në zhvillimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta.
- 5.4. Për çdo projekt të përbashkët, do të përcaktohen kushtet e punës, përgjegjësitë dhe detyrat e secilit partner, si dhe afati kohor për përfundimin e projektit.

Pika 6

Pjesëmarrja në projekte të përbashkëta

- 6.1. UHZ dhe DCo do të bashkëpunojnë në zhvillimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta, të cilat mund të përfshijnë hulumtim shkencor, zhvillim teknologjik dhe inovacion në industrinë e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
- 6.2. Projekte të tilla mund të përfshijnë edhe punësimin e studentëve të UHZ për të ndihmuar në kryerjen e detyrave dhe aktiviteteve të projektit.
- 6.3. Për sa i përket projekteve të përbashkëta, të gjitha të drejtat intelektuale do të jenë të përbashkëta midis UHZ dhe DCo;
- 6.4. Këto projekte do të kenë për qëllim të promovojnë bashkëpunimin midis UHZ dhe DCo, si dhe të ndihmojnë në zhvillimin e njohurive dhe aftësive të studentëve dhe personelit të korporatës.
- 6.5. Palët do të bashkëpunojnë në organizimin e konferencave dhe seminareve të përbashkëta dhe do të inkurajojnë pjesëmarrjen e studentëve, personelit akademik dhe të profesionistëve të tjerë.



Pika 7 Hulumtimi i tregut

UHZ dhe DCo akordohen që nëpërmjet "Institutit për Shkencë dhe Arte" dhe studentëve të UHZ, të hartojnë anketa, pyetësorë dhe mjete të tjera për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave empirike lidhur me treguesitë e tregut dhe produkteve specifike me interes për palët;

Pika 8 Forumi për zhvillim ekonomik rajonal të zonës së Dukagjinit 2023

UHZ dhe DCo akordohen që së bashku të kontribuojnë në krijimin dhe zhvillimin e projektit të forumit për zhvillimin ekonomik rajonal të zonës së Dukagjinit 2023, secila nga këndi dhe roli që kanë në kuadër të kësaj ndërmarrjeje;

Pika 9 Monitorimi i marrëveshjes

Të dyja palët do të krijojnë një mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e kësaj marrëveshjeje të bashkëpunimit, duke përdorur indikatorë specifikë dhe duke raportuar rregullisht për përparimin e arritur dhe sfidat eventuale në proces.

Pika 10 Partneriteti dhe promovimi i bashkëpunimit

- 10.1. UHZ dhe DCo do të promovojnë bashkëpunimin e tyre në media dhe aktivitete publike, duke treguar rëndësinë e një partneriteti të fortë dhe të qëndrueshëm midis institucionit të arsimit të lartë dhe industrisë.
- 10.2. UHZ dhe DCo do të bashkëpunojnë për të zhvilluar dhe zbatuar programe trajnimi dhe seminare për personelin e tyre në fusha specifike të interesit të tyre.
- 10.3. Këto përpjekje do të ndihmojnë në ritjen e ndërgjegjësimit publik për ndërveprimin midis UHZ dhe DCo, si dhe të tërheqin interesin e studentëve, personelit akademik dhe të biznesit për të bashkëpunuar në projekte të përbashkëta.

Pika 11 Kohëzgjatja e marrëveshjes

- 11.1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë prej pesë vjetësh.
- 11.2. Pas përfundimit të kësaj periudhe, marrëveshja mund të rinovohet ose ndryshohet në bazë të nevojave të momentit dhe të interesave të përbashkëta.

Pika 12
Zbatimi i Marrëveshjes

- 12.1. Kjo marrëveshje do të zbatohet në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë.
- 12.2. Çdo mosmarrëveshje midis palëve do të zgjidhet në një mënyrë miqësore, në përputhje me praktikat dhe procedurat e rëndësishme të ndjekura në biznes dhe industrinë.
- 10.1. Të dyja palët do të bashkëpunojnë dhe do të koordinohen në mënyrë të ndershme dhe efektive në zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe në arritjen e qëllimeve të saj.
- 10.2. Asnjë mosmarrëveshje nuk do të adresohet në asnjë institucion ose organ gjyqësor ose ndërmjetësues;


Nënshkruar nga:

Për: Universitetin Haxhi Zeka

Rektor i Universitetit "Haxhi Zeka"

Për: Devolli Corporation

Z. Barlet Imami, Përfaqësuesi i Korporatës Devolli



			
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERSITET "HAXHI ZEKA" PEJË	
REKTORATI			
Nr. / Br. / No. <u>462</u>		Nr. i faq/ Br. str / No. pg <u>5</u>	
Data / Datum / Date <u>06/03/2023</u>		Pejë / Poë	